While a significant part of Total Physical Response (TPR) focuses on movement and action-based learning, integrating translation and writing instruction in TPR poses difficulties and obstacles. The possible withdraw between the cognitive processes involved in writing and translating and the physicality of TPR is one of the major challenges. The primary goal of TPR is to support language acquisition through physical gestures and movements (Asher 2000), which might not be entirely consistent with the thought processes needed for writing and translation assignments. It can be difficult for learners to switch between the mental processes of understanding, translation and composition, which can cause confusion.

Furthermore, TPR's reliance on physical movement can restrict the range and complexity of writing and translation tasks that can be successfully carried out. It can be difficult for learners to effortlessly blend the cognitive processes of

analysis, synthesis, and interpretation that translation and writing projects need with TPR's emphasis on physical activities. It could be challenging for educators to create translation and writing exercises that take full use of TPR's kinesthetic learning opportunities while still encouraging meaningful language use and cognitive involvement. Consequently, learners' overall language competency and growth may be hampered by translation and writing teaching in TPR that does not adequately address their language learning goals and objectives.

Evaluating writing and translation assignments in TPR also poses some difficulties. Since traditional assessment techniques frequently place a higher value on written output and linguistic accuracy rather than on communicative fluency and physical enactment, they may not be sufficient to fully capture learners' language proficiency and progress in the setting of TPR. There may be differences between the objectives of instruction and the results of assessments if teachers find it difficult to evaluate learners' proficiency in writing and translation within the TPR framework. For teachers implementing translation and writing instruction in TPR situations, identifying appropriate assessment methodologies that are in line with TPR principles and effectively measure learners' language acquisition progress remains a key problem.

5. Discussion
The Grammar Translation Method (GTM), Communicative Language Teaching (CLT), and Total Physical Response (TPR) all have distinct techniques, difficulties, and teaching strategies that must be considered when examining translation and writing instruction. CLT and TPR place more emphasis on communicative ability and language fluency through meaningful engagement and physical enactment, whereas GTM emphasizes the mechanical memorization of vocabulary and grammar rules through translation exercises. The differing pedagogical tenets and ideologies behind these approaches have a big influence on how translation and writing instruction are used in language education.
The Grammar Translation Method emphasizes correctness, precision, and faithfulness to the source text in translation as a key pedagogical instrument for language learning. Exercises involving direct translation—that is,

translating sentences or passages from the target language into the native language and back again—are frequently used to support vocabulary development, grammatical structure, and comprehension abilities. Although GTM makes clear language norms and conventions easier to understand, communicative competence is frequently overlooked, and learners' oral fluency and communicative skills are not developed.

Conversely, Communicative Language Teaching places more emphasis on language fluency and communicative competence than linguistic accuracy and promotes authentic communication and meaningful interaction in real-life circumstances. In CLT, writing instruction and translation are included in communicative activities like debates, role-plays, and group projects where students use language intentionally and write about their thoughts, feelings, and experiences. CLT promotes meaningful language learning experiences by fostering language production, creativity, and cultural awareness through the placement of writing activities inside authentic communicative settings.

Through multimodal techniques that integrate kinesthetic, aural and visual cues, Total Physical Response-which emphasizes physical movement and action-based learning—offers distinctive options for translation and writing instruction. Translation and writing assignments can be scaffolded and integrated inside TPR activities to reinforce language concepts and encourage cross-modal learning experiences, even though TPR is generally connected with oral skill and listening comprehension. While retaining the method's emphasis on experience learning and language acquisition, educators can support translation and writing teaching in TPR situations by integrating gestural cues, physical prompts, and interactive technology resources.

Teachers can use the concepts and strategies of GTM, CLT, and TPR to create successful language learning programmed that meet the requirements and preferences of a wide range of learners, despite the unique traits and teaching approaches associated with each approach. By using a flexible and eclectic approach to language teaching, teachers can take advantage of each method while addressing its drawbacks, helping learners become more linguistically competent and culturally aware.

BIBLIOGRAPHY

Asher, J. J. 2000. *Learning another language through actions.* California: Sky Oaks Productions.

Asher, J. J. 1969. "The total physical response approach to second language learning." *The Modern Language Journal* 53: 3-17.

Asher, J. J., & Kusudo, K. 1978. "Learning A Second Language Through Commands: The Second Field Test." *Modern Language Journal* 58: 24-32.

Brown, Douglas. 2007. *Teaching by Principles.* London: Longman.

Brown, H. & Lee, H. 2015. *Teaching by Principles: An Interactive Approach to Language Pedagogy (4th Edition).* Pearson Education ESL. doi:978-0133925852.

Canale, M., & Swain, M. 1980. "Theoretical Bases of Communicative Approaches to Second Language Teaching and Testing." *Applied Linguistics* 1-47.

Cook, G. 2010. *Translation in Language Teaching: An Argument for Reassessment.* Oxford: Oxford University Press.

Corder, Pit. 1981. *Error Analysis and Interlanguage.* Oxford: Oxford University Press.

Ellis, R. 1997. *SLA research and language teaching.* Oxford: Oxford University Press.

Frost, Richard. 2023. "Total Physical Response - TPR." *British Council.* https://www.teachingenglish.org.uk/professional-development/teachers/managing-lesson/articles/total-physical-response-tpr.

Howatt, A. 1984. *A History of English Language Teaching.* Oxford: Oxford University Press.

Larsen-Freeman, D. and Anderson, M. 2000. *Techniques and Principles in Language Teaching (2nd ed.).* Oxford: Oxford University Press.

Nunan, David. 2004. *Task-Based Language Teaching.* Cambridge: Cambridge University Press.

Richards & Rodgers. 2016. *Approaches and Methods in Language Teaching.* Cambridge: Cambridge University Press.

Savignon, S. 1991. "Communicative language teaching state of the art." *TESOL Quarterly* 25: 261-275. http://dx.doi.org/10.2307/3587463.

Rahim OMBASHI

MERGER OF RELIGIOUS STATUS WITH NATIONAL STATUS THROUGH TEXTUAL AND HISTORICAL FACTS

Abstract

Through this paper, I present one of the precious elements of the religious and national creative activity of Hafiz Ali Korça, such as his contribution to the writing and publication of Mevlud in the Albanian language and not in the Arabic or Ottoman alphabet. The first Mevlud in the Albanian language is the work of the alamiado author Hasan Zyko Kamberi. After him came other mevluds, but written in the Ottoman alphabet. Hafiz Ali started his literary creativity with the publication in 1900 of the books entitled *Mevludi*, which was written and published with the Istanbul alphabet. Before this edition, it was printed in Istanbul *Mevludi* in Ottoman alphabet, written by Sulejman Çelebiu and translated by Hafiz Ali Ulqinaku. In 1905, another mevlud was published in Istanbul, but this one also in the Ottoman alphabet.

We will teach the analysis and critical argumentation of H. Ali's position as well as extract the pure influence of the foundational work on the writing of the language, culture and Albanian life of the time. With the previous edition, he remained at the missionary status, which is concretely a religious, national, social and doctrinal status. As a solitary creator, by means of poetic fragments he manages to call the interlocutor, which in the case of literary communication is the reader or listener. *Mevludi* was received with interest, so much so that spaces were opened for its improved reprints afterwards. By not

---

[23] Prof. Assoc. Dr. Rahim OMBASHI
 University College "Bedër"

writing Albanian with the Greek alphabet, as was written and published "Albanian Bee" by his fellow citizen Thimi Mitko, Mevludi took a step forward towards the acceptance of the Monastery alphabet. Hafiz Aliu participated in the Literacy Congress; therefore, he printed the reprints made in 1909-1923-1944 with this alphabet. It will be proven that his creative work with Islamic themes served for writing in the Albanian language, enriching written speech. He published his artistic, religious and educational works with the monastery alphabet. As an educator of the nation, as a missionary of the Islamic religion and a national activist, H. Ali aligns himself with the spiritual leaders of the Albanian nation.

SHKRIRJA E STATUSIT FETAR ME ATË KOMBËTAR PËRMES FAKTEVE TEKSTUALE DHE HISTORIKE

Abstrakt

Përmes këtij punimi, paraqes një nga elementet e çmuara të veprimtarisë krijuese fetare dhe kombëtare të Hafiz Ali Korçës, siç është kontributi i tij në shkrimin dhe botimin e *Mevludit* në gjuhë shqipe dhe jo me alfabet arab ose osman. *Mevludi* i parë në gjuhën shqipe është vepër e autorit alamiado Hasan Zyko Kamberi. Pas tij dolën mevlude të tjera, por të shkruara me alfabet osman. Hafiz Aliu e nisi krijimtarinë letrare me botimin në vitin 1900 të librit titulluar *Mevludi,* që u shkrua dhe u botua me alfabetin e Stambollit. Para këtij botimi, ishte shtypur në Stamboll me alfabet osman *Mevludi*, shkruar nga Sulejman Çelebiu dhe përkthyer nga Hafiz Ali Ulqinaku. Në vitin 1905 u botua në Stamboll një tjetër mevlud, por edhe ky me alfabet osman.

Do t'i mëshojmë analizës dhe argumentimit kritik të pozicionit të H. Aliut si dhe të nxjerim ndikimin e pastër të veprës themeltare në shkrimin e gjuhës, kulturën dhe jetën shqiptare të kohës. Me botimin parak mbeti te statusi i misionarit, që konkretisht është status fetar, kombëtar, shoqëror e doktrinar. Si krijues i vetmuar, me anë të grishjeve poetike arrin të thërrasë bashkëbiseduesin, që në rastin e komunikimit letrar është lexuesi apo dëgjuesi. Mevludi u prit me interes, aq sa u çelën hapësira për ribotimet e përmirësuara të tij më pas. Duke mos e shkruar shqipen me alfabet grek, siç u shkrua dhe u botua Bleta Shqiptare e bashkëqytetarit të vet Thimi Mitko, *Mevludi* hodhi një hap para drejt pranimit të alfabetit të Manastirit. Hafiz Aliu mori pjesë në Kongresin e Alfabetimit, prandaj me këtë alfabet i shtypi ribotimet e kryera të vitit 1909-1923-1944. Do të provohet që vepra krijuese e tij me tematikë islame, shërbeu për shkrimin në gjuhën shqipe, pasurimin e të folurit me shkrim. Me alfabetin e Manastirit ai botoi veprat e tij artistike, fetare, arsimore. Si edukator i kombit, si misionar i fesë islame dhe veprimtar kombëtar H. Aliu rreshtohet me prijësat shpirtërorë të kombit shqiptar.

Key words: *Mevludi*, *statusi i misionarit, statusi i autoritetit, anastatikë, ekdotikë, status shoqër, status doktrinar, funksioni komunikativ, Kongresi i Alfabetimit,*

Hyrje

Mevludi i shkurtër në gjuhën shqipe, hartuar nga autori alamiado Hasan Zyko Kamberi, është krijim i shekullit të 18-të dhe është shkruar me alfabet arab, të përshtatur për gjuhën shqipe. Pas tij u botuan mevlude të tjera në gjuhën shqipe, që ishin përkthime ose punime të mirëfillta, por të shkruara me alfabet osman.

Hafiz Ali Korça e nisi krijimtarinë e tij letrare me botimin e një vepre me tematikë islame në vitin 1900. Libri i titulluar *Mevlud*, i cili i kushtohet ditëlindjes së Mbretit të profetëve, u shkrua dhe u botua me alfabetin e Stambollit. Para këtij botimi, ishte shtypur në Stamboll në vitin 1879, me alfabet osman, *Mevludi* i shkruar nga Sulejman Çelebiu në vitin 1409, tekst i përkthyer nga Hafiz Ali Ulqinaku. Më këtej, në vitin 1905, u botua po në Stamboll *Mevludi* i hartuar nga Muhammed Tahiri në gjuhën shqipe, edhe ky shkruar me alfabet osman. Në rastin e figurës poliedrike të Hafiz Ali Korçës të shkojnë nëpër mend fjalët e Oscar Wilde:

"Çdokush mund të bëjë histori. Vetëm një njeri i madh mund ta shkruajë atë."

Me të drejtë pohojmë se ai, personaliteti i kulturës sonë kombëtare, mundi ta shkruajë historinë e kombit të vet edhe përmes veprave fetare, që aq fort shijoheshin nga masa analfabete e popullsisë duke i dëgjuar apo ndjeheshin dhe kuptoheshin duke u lexuar nga një numër jo fort i madh shqiptarësh. Botimi i tij i parë ishtë një mevlud, pra krijim me tematikë fetare, por kjo nuk e pengonte Hafiz Ali Korçën (H. A. K., Hafiz Aliu) t'i mëshonte funksionit edukativ të krijimit të tij, pa lënë mënjanë funksionin komunikativ dhe atë hedonistik. Ishte i ndërgjegjshëm se me krijimin në vjershë ndihte në edukimin patriotik të masave të gjera dhe njëkohësisht vendoste komunikimin me atë që kishte mundësi ta lexonte mevludin apo me ata që e dëgjonin të kënduar në përvjetorët e ditëlindjeve të profetit të zgjedhur (Mustafa). Ai *njëtoi* (neologjizëm i H. A. K.) Zotin duke mos i bërë ortak. I gëzon zemra vjershëtorit, ngashërehet si mysliman prej caktimit prej Tij *vëntzënës* (TË PARË, neologjizëm i H.A.K.) të gjithësisë.

Statusi militant e ngre H. Aliun në nivel të auktorialitetit dhe i autoritetit, duke marrë rolin e predikuesit fetar dhe kombëtar, si dhe duke u kthyer në veprimtar, prijës dhe autoritet. Ai luan me emocionet e lexuesve të pakët, por të dëgjuesve më të shumtë me anë të këtij krijimi të shkruar në vargje 12-rrokëshe, me rimë të përputhur, formatuar në njëshkolonë.

Përsa i takon funksionit estetik të *Mevludit*, mund të pohohet me siguri se mbeti i integruar brenda doktrinës kombëtare të kohës, pa kaluar në nacionalizëm dhe idealizim të prijësit. Doktrinat janë një fenomen i një epoke të caktuar, madje ato mund të rishfaqen:

"Por në vitin 2022 mund të arsyetohej bindshëm se regjimi i Putinit ishte përnjëmend fashist. Ekzistonte kulti i një udhëheqësi të vetëm, një estetikë e dhunës marciale dhe e vdekjes heroike, kultivimi i ndjenjës së pakënaqësisë historike, indoktrinimi i rinisë, persekutimi i pamëshirshëm i pakicave kundërshtare, ideologjia e dominimit nga ana e një *Volk*-u përmbi të tjerët dhe demonizimi i armikut." (ASh, 2023: 441)

Mevludin e vet të parë e botoi në vitin 1900, vit kur mbylli sytë përgjithmonë Naim Frashëri. Aso kohe sedra kombëtare po ngjizej si ndërgjegje kombëtare, prandaj koha nuk priste më që shqipja e lashtë të vijonte të realizonte komunikimin vetëm si gjuhë e folur:

"Komb i Shqiptarëvet, nga të mos shkruarit' e gjuhës së vet, ka humburë gjer më sot më të shumët'e njerëzet; po në ka humburë aqë në kaqë mijë vjet, ata që kanë mbeturë do t'i humpnjë më fort pakë kohë, se koh'e sotme nukë ngjan me kohërat e vjetëra; sot kombetë piqen'e përzjehenë fort çpejt, edhe ata që janë më të fortë e më të diturë, mundinë kurdoherë ata që janë të dobët'e më të paditurë." (FRASHËRI, 1879: 28).

Kur i shkroi Samiu këto radhë gjithë shqetësim, gjuha shqipe nuk ishte një gjuhë e pashkruar, sepse kishte nisur të dokumentohej qysh tre shekuj më parë, por numri i shqiptarëve që dinin të shkruanin e të lexonin 'numërohej me gishta'. Për këtë shkak H. A. Korça shpejtoi të botonte veprën e vet të parë, jo vetëm se komunikimi fetar ishte mbizotërues asokohe, por edhe se pas kryengritjeve me armë të kohës së Tanzimatit (1840-1850), pas dështimit të

Lidhjes së Prizrenit (1878-1881), pas themelimit të Shoqërisë së Stambollit (1879) dhe botimit në Stamboll të "Alfabetarja e gjuhësë shqip" (1879) koha më nuk priste:

"Dëshira për të studiuar dhe për të shkruar mbi ndikimin dominues të religjionit në krijimin ose modelimin e mentaliteteteve, jo vetëm të atyre individuale dhe sociale,por edhe të atyre etnike, më ka lindur disa vite para se vërtetë t'ia filloja punës për realizimin e këtij studimi. Nxitësi, padyshim vendimtar, për t'u marrë me këtë temë ishte libri "Sëmundja teknokrate" i autorit Alain Peyrefitte." (KRASNIQI, 2013: 7)

Ky ndikim mbizotërues i besimit fetar në krijimin e mendësisë etnike, cekur me dinjitet shkencor nga punimi i mësipërm, ka qenë ylli polar i veprës së Hafiz Ali Korçës (1873-1957). Lëvizja kombëtare ndër shqiptarët kishte më herët ngjyrim të dukshëm fetar, për të kaluar më pas në atë etnik e kombëtar. Sedra dhe patriotizmi, që nuk munguan kurrë te shqiptarët, duhej të drejtoheshin dhe mbështeteshin te kultura, te dokumentimi i saj nëpërmjet gjuhës së shkruar me alfabet përbashkues, sipas proverbit latin *Verba volant, scripta manent*.

Koha historike nuk u vinte dot në ndihmë patriotëve shqiptarë, që kryesisht jetonin dhe punonin jashtë vendit. Në mërgim ishin vendosur lidhje me Shoqërinë Biblike Britanike, por po krijohej bindja se përgjegjësia themelore ishte e vetë shqiptarëve. Hafiz Aliu ishte suni për nga shkolla e besimit islam që praktikonte, por ai kishte lidhje gjaku me familjen Frashëri dhe bashkëpunoi me frashëllinjtë e mëdhenj Naim, Sami dhe Mithat, qysh gjatë periudhës kur studionte në Stamboll:

"Fatkeqësisht, Porta e Lartë nuk u tregua largpamëse dhe shqiptarëve, në ato kushte aspak të volitshme, u mbetej të mbështeteshin në forcat e veta dhe në përkrahjen pothuaj të plotë të sektit bektashian dhe të Lëvizjes Ungjillore Britanike e Amerikane. Pas dështimit të Lidhjes Kombëtare të Prizrenit, për patriotët shqiptarë u bë e qartë se lufta për ekzistencën e kombit duhej të bëhej në fushën e kulturës, më saktësisht në popullarizimin e shkrimit kombëtar me shkronja latine, si dhe në organizimin e arsimit në gjuhën shqipe, si hap i parë, elementar, që do të pengonte tendencat shkombëtarizuese greke, serbe,

bullgare dhe osmane. Në këtë fushë, Shoqëria Biblike Britanike dhe bektashizmi, me përkthimet e tyre fetare dhe me përqafimin e ideve progresiste, ndihmuan shumë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare." (KRASNIQI, 2013: 16)

Ndihmesa reale dhënë në shkrimin e gjuhës shqipe

H. Aliu botoi gjithsej 2.094 faqe *Vjershë* dhe 11.562 faqe *Prozë*, do të thotë gjithsej 13.656 faqe. Në një fjalë të mbajtur në vitin 1929 ai dëshmon se i kishte kaluar dhjetë mijë faqet e botuara në libra të ndryshme. Duket diferencën prej rreth katër mijë faqesh do ta ketë shtuar në periudhën nga viti 1929 deri në vitin 1944, sepse pas kësaj kohe për H. Aliun filloi kalvari antiteist. Po t'i shtojmë këtij numri bukur të madh dhe faqet e plotësuara plot kujdes e mjeshtëri të ribotimeve, që jo rrallë përplotësoheshin me ide të reja, del volumi i jashtëzakonshëm i punës intelektuale krijuese, të cilën ai la trashëgim. (KORÇA, 2006: 117)

Seria e *Veprave* të H. Ali Korçës ka 22 tituj gjithsej të shoqëruara me shënime nga Prof. Dr. Ismail Ahmedi. Botimet e këtij personaliteti kombëtar, që fillojnë në vitin 1900 me *Mevludin*, janë:

- *Mevlud* (Lindja e Pejkamberit) fq. 30, *Vjershë* 1900.
- 300 *Fjalë të Imami Aliut*, fq. 30, *Prozë*, 1900.
- *Jusufi me Zilihanë*, fq. 100, *Vjershë*, 1900.
- *Besimet Islame edhe Filozofitë e fevet të ndryshme edhe partitë në Fenë Islame*, fq. 400, *Prozë*, 1900.
- *Histori e Shejtë*, fq. 1.000, (75.000 vargje, *Vjershë*), 1900.
- *Dameneja dhe kalileja prej Sankristes*, fq. 500, *Prozë*, 1900.

Siç shihet gjatë vitit 1900 H. Aliu ka botuar gjashtë libra me rreth 2.060 faqe, çka të shtyn të mendosh se janë vepra të shkruara jo vetëm atë vit apo ato kohë, por më herët. Duket shpresa për botime në gjuhën shqipe po gjente hapësirë në fillim të shekullit të ri, atij të njëzetë. Ndërkohë po lulëzonte publicistika, ku ai gjithashtu ka një veprimtari të spikatur:

"Dy periodat qi përmendëm më sipër perioda 1882-1908 dhe perioda 1908-1913 janë periodat më aktive dhe shumë importante të shtypit kombtar, i cili, i varfër si në personel dhe në mjete, i ka dalë zot misionit të tij shumë të rëndë dhe këtë e ka plotësuar plot nder e lavdi." (ZAVALANI, 1937: CLXVIII)

Bashkë me shtypin publicistik, në periudhën 1882-1913 u shtuan edhe botimet fetare islame me alfabete të ndryshme, por jo me atë arab të përshtatur për shqipen. Nuk është pak të shohësh që bashkë me publicistikën kombëtare, po ecte dhe letërsia fetare islame, që gjithashtu i shërbente interesit të krijimit e përforcimit të sedrës kombëtare, si bazë për krijimin e ndërgjegjes kombëtare. Me alfabet arab të përshtatur për shqipen ishte shkruar një letërsi e tërë, që i shërbeu ruajtjes dhe pasurimit të gjuhës shqipe, aq më tepër që ajo kishte mbetur te themelet e letërsisë sonë.

Rexhep Ismajli te libri *Tekste të vjetra*, Pejë, 2.000, e mbyll vlerësimin për këtë letërsi me një konkluzion të Hasan Kaleshit:

"… letërsia alamiado është letërsia e parë artistike ndër shqiptarë…" (OMBASHI, 2020: 150)

Me alfabet arab të përshtatur për gjuhën shqipe u shkrua *Divani* i Nezimit e deri vepra më e popullorëzuar e Rilindjes Kombëtare, *Erveheja* e Muhamet Çamit, e cila duke qenë në vargje mund të mësohej përmendësh edhe pa ditur shkrim e lexim në shqip:

Sidoqoftë, i gjithë ky bilanc pozitiv tregtar, në gjysmën e parë të shekullit XIX, padyshim rilindi jetën kulturore, duke sjellë në skenë një brez të ri intelektualësh shqiptarë, të edukuar dhe të arsimuar në institucionet më prestigjioze të Perandorisë Osmane. Ata shkruajnë poezi në gjuhën shqipe, por në mungesë të alfabetit kombëtar, përdorin shkronjat arabe. Pra, mungesa e shkronjave shqipe[24] ishte komponente që pengonte ringjalljen shpirtërore dhe kombëtare. Megjithatë, bejtexhinjtë shqiptarë me qendër kulturore në Berat, bëjnë hapat e parë drejt një rruge të gjatë të rizgjimit kombëtar shqiptar. (KRASNIQI, 2013:27)

---

[24] Në shekullin XVII dhe XVIII në viset e banuara me shqiptarë dhe boshnjakë lulëzojnë institucionet kulturore islame si mejtepet dhe medreset, në të cilat arsimoheshin banorët lokalë të islamizuar.

Të njëjtat vështirësi që duhej të kaloheshin në botimin e letërsisë fetare ishin dhe për atë artistike, por kurajoja e fortë patriotike ndihmoi që rruga e nisur drejt krijimit të alfabetit kombëtar nuk mund të ndalej:

"Këto masa kaqë t'egra nuk thyen kurajon e pa shembëlltë të Shqiptarve as Brenda, as jashtë Shqipris dhe këta vazhduan të botonin fletoret e rivistat e këto, me shumë mundime e rezike me anën e postave të huaja, i shpërndanin në vendin t'onë."

<div align="right">(ZAVALANI, 1937: CLXVI)</div>

Statusi i militantit fetar dhe kombëtar

Pas këtij viti, H. Aliu vijon me intensitet të botojë vepra artistike, tekste didaktike dhe fetare në gjuhën shqipe, duke e bërë kështu gjuhën e vendit jo vetëm gjuhë fetare por edhe gjuhë të kulturës, që shërbente dhe për vendosjen e themeleve të një kulture shpirtërore dhe morale:

- *Abetare shqip* (1910).
- *303 fjalë të Imam Aliut* (Botuar në Korçë më 1910).
- *Fe Rrëfenjësi, morali* (1914).
- *Gramatika, Syntaksa shqip - arabisht edhe fjalime*, (1916).
- *Jusufi me Zelihanë* (Botuar në Elbasan më 1923).
- *Tefsiri i Kur'anit*, (mbetur dorëshkrim, me një vëllim prej 2.000 faqesh, R. Z.) punuar gjatë viteve 1920-1924.
- *Historia e shenjtë dhe të katër halifetë* (Botuar në Tiranë më 1931, fq. 288).
- *Shtatë Ëndrrat e Shqipërisë*, Poezi, (Botuar në Tiranë më 1944).

Një rëndësi të veçantë për krijimtarinë dhe veprimtarinë e tij kanë gjithashtu edhe tekstet shkollore të përgatitura, por që nuk mundën të shihnin dritën e botimit, si:
- *Filosofi e vjetër;*
- *Filosofi mbi besimet myslimane;*
- *Logjika.*

Deri në vitin 1929, autori prodhimtar, pohon se ka ka shkruar më tepër se dhjetë mijë faqe, madje kërkon nga KMSH që të shtypen ato vepra, të cilat

ende nuk e kishin parë dritën e botimit. Nga fjala e tij mësojmë se në qeverinë e Ismail Qemalit i ishte ngarkuar Ministria e Arsimit:

"Më këshillonin miqtë: 'Hiq dorë, se do të të vrasin', por kurrë nuk u ndalova nga veprat e mia. Kurdoherë dhe në çdo vend nuk pushova së bëri propagandë për idenë kombëtare, por nuk do t'i përmend një e nga një se këto dihen, prandaj nuk do t'ju mërzit zotërinë Tuaj, vetëm do ta lus që për dhjetë mijë e sa faqe që kam shkruar si: *Thelb i Kur'anit* etj. d.m.th. për këto shërbime fetare e kombëtare të shënohem dhe unë në një qoshe për kujtim dhe, po të shihen të nevojshme, të shtypen, se librat, siç thotë një fjalë, janë jetë e dytë e njeriut. Tashti dhe unë kam nevojë për çlodhje." (DEMETJA, 2023: 83)

H. Aliu te libri *Nj'a dy fjalë për shtypjen' e pestë* të *Mevlud* (Lindja e Pejkamberit), fq. 30, Vjershë 1900, që është vendosur si fjalë përshëndetëse te ribotimi i gjashtë (Waterbury, Connecticut, U.S.A., 1950), informon:

"Disa vjet ma parë ky *Mevlud* u shtyp dy herë në Shtypëshkronjët "Korça". … Të tretën herë u shtyp në Shkodër dhe të katërën herë prapë në Korçë."

Bëhet fjalë për botimin e vitit 1900, i pari, dhe ribotimin e atij të vitit 1909, i dyti, të dyja veprat të kryera në shtypshkronjën "Korça". Ribotimi i Shkodrës, ndoshta i treti me 562 vargje, del të jetë kryer para vitit 1920, kur, po në Korçë, kryhet ribotimi i katërt. Ribotimi i pestë, ai i vitit 1944, bëhet në Tiranë.
Tri botimet e *Mevludit*, 1909, 1920 dhe 1944, janë botime ***anastatike***, si në origjinal, gjenden te Vëllimi 7 *Myslimanija*; *Mevludi* 1909-1920-1944; *Treqint-e-tri fjalët e Imami Aliut*" nga *Vepra* me 12 vëllime, pas shkrimit didaktik *Myslimanija*.

Nga botimi në ribotim ka përplotësime te vepra *Mevlud* në numrin e vargjeve dhe të faqeve të broshurës: 1909-1920-1944: (1909: 444 vargje), faqe 43; (1920: 562 vargje), faqe 67; (1944: 580 vargje), faqe 93; duket që ka pasurim me vargje dhe ide, kësisoj duhet të quhen ribotime të përmirësuara.
Te botimi pretencioz Hafiz ALI KORÇA: Vëllimi 7, 14 x 21,5 / fq.146 / 2006, mësojmë se ribotimi i dytë në Korçë, i cili është i vitit 1909 (444 vargje), duket është ai që ka shërbyer si shabllon për botimin e veprës së plotë.

SHTYPJE E KATËRTË, ajo e vitit (1920: 562 vargje), u krye në Librëtorja "KORÇA" Kotti & Xoxe, gjithashtu është një ribotim.

Ribotimi i pestë, i vitit (1944: 580 vargje), është kryer te Shtypshkronja e Shtetit, Tiranë, prandaj rishtypja e gjashtë (1950, dhjetor 22: 580 vargje), del i njëjtë me atë të vitit 1944.

Po qëndrojmë fort te *Teksti*, prej nga le të fillojmë të hyjmë te *Para-teksti*, *Pas-teksti* e *Kon-teksti* i *Mevludit*, duke nxjerrë pjesë e kuptime deri më sot të panjohura të vlerave të saj krijuese, por së bashku me atë të historisë së vetë popullit shqiptar.

Të tërtherurit (*sakrifica*) për gjuhën shqipe

Do të punojmë e mbështetemi mbi botimin e vitit 1944, por duke mos lënë mënjanë botimin e parë të vitit 1900. Asokohe H. Aliu sapo ishte kthyer nga Stambolli në Korçë, ku vlonte një veprimtari e fuqishme atdhetare. Iu bashkua edhe ai, sidomos me penë, sepse kur duhej rrëmbeu pushkën e doli në krye të një çete luftëtarësh. E ndiente më fort sesa e shihte nevojën që kishte koha patriotike. Librat e botuar nuk do t'i sillnin para dhe aq më shumë emër, por i duhej të ecte shpejt e me siguri në udhën e të parëve, shumë prej të cilëve korçarë në mërgim, që kishin vepruar kësisoj:

"Mbë të gjitha anët e jetës [=botës] dihet që gjuh' e vendit (protimite) [=mban kryet e vendit] edhe është më e duëshme (iktizallie) e të huajat janë vetëm për fort pak, që kanë të bëjnë me të jashtmit… […] (G)jat e gjërë munt ta theres e ta rëfenj mundimin' e mkotë që kanë hequr e heqin djemtë shqipëtarë …me të dhënit e të mpuarit gjuhëve huaji.[…]

Gjithë ato e t'atilat, o djelm! tyke vurë përpara syvet mi, më nxehnë e më stërnguan që t'I hynj kësaj ndërduarçmje (epihirisis) e kësaj të insure, pa kujtuar fare mundim a të lodhur, se e dinja e e njihnja që s'e bënj për ndonjë të mburm që të rëfenj ndë sy të njerëzve, po vetëm që të bënj e të rëfenj tëtirën (borxhin) që kesh e kam për Ventlermin tem e për gjuhën time e të babës. … (S)a vjet i madhi Zot të më falnjë i kam për të tërthertur tyke punuar për vëndin tem e tuajnë edhe për këtë gjuhënë tënë." (MITKO, 2020: 36)

Në punë të alfabetit, nuk eci në udhë të bashkëqytetarit të vet Mitko, që e botoi *Bletën Shqiptare* me alfabet grek, sipas ndikimit të Kamardës, por zgjodhi atë të Stambollit. Më pas mbështeti alfabetin e zgjedhur në Kongresin e Manastirit, ku dhe mori pjesë (tani vonë ka dalë ky dokument), çka u reflektua me ribotimet e *Mevludit* pas vitit 1908.

Lehtë mund të gjenden ndikime nga Naim Frashëri dhe bektashizmi shqiptar, që ishte kthyer në "një lëvizje fetare të etnicizuar". (DOJA, 2022: 101) Ky tipar i lëvizjes fetare ndër shqiptarët e Ballkanit, më pas do të kalonte në një stad më të lartë, kur vë në themel të veprimtarisë së vet sloganin FE-ATDHE, brenda të cilit hynë dhe vijojnë të qëndrojnë të gjitha besimet monoteiste, që praktikohen nga shqiptarët.

Është e drejtë e gjithkujt të mendojë dhe të shkruajë për çështje dhe probleme kaq të rëndësishme kombëtare dhe shkencore, por kumti i shkruar duhet ta mbështesë mendimin me fakte e dokumente të sakta, që argumenti të mos jetë emocional apo ideologjik. Studiuesi Doja, i cili ka sjellë disa punime mbi bektashizmin shqiptar, është shprehur te libri i vet, tashmë i përkthyer nga anglishtja:

"Gjithashtu, theksimi i fortë nga ana e Naim Frashërit mbi botëkuptimet panteiste mund të mendohet se e ka shtyrë bektashizmin kundër monoteizmit sunit mbizotërues që i shërbente centralizmit perandorak otoman." (DOJA, 2022: 101)

Sunizmi shqiptar dhe aq më fort mirësia e gjallë H. Ali, në veprimtarinë e tij fetare, kulturore dhe krijuese, ashtu si Naimi, shkriu në një botën filozofike me atë fetare, duke përftuar vepra e realizuar veprimtari në shërbim të gjuhës dhe kombit, duke i rënë ndesh çdo lloj centralizmi, aq më tepër të huaj:

"Nëntëdhjetë vjet më parë Naimi u dëftente Shqiptarëve Perëndimin si shëmbëll qytetërimi, pse si pas mendimit tij vetëm nga ajo anë, dhe jo nga Lindja, vjen drita. Të gjithë e mbajmë mend një vjershën e tij të mallëngjyer: "Për se? / Pse s'vjen o dit' e mirë / Pse vallë nuk vjen?/ Gjer kur në errësirë?/ Mos Zoti të pëlqen?/ As hidhe gardhë / Dhe shpejto pakë,/ O dit' e bardhë,/

Dhe jakë, jakë,/ Se të pres / Nuku vdes./ Jak'o dit'e uruar,/ Që lint nga perëndon,/ At'an' e ka ndrituar,/ E ne pse na haron?/ Dritëz' e jetës,/ Edhe e motit / Dh'e së vërtetës,/ Dhe gaz'i Zotit / Ndritona / E xgjona". Si duket, edhe nëntëdhjetë vjet më parë ishte një gardh që e ndante Shqipërinë nga Perëndimi. Eshtë aktual si poet. Personalitet i pajisur me një spiritualitet dhe religjiozitet të jashtëzakonshëm, sado që u nis nga poetët mistojë persjanë, ndaj të cilëve e prinin natyra e tij e butë dhe besimi bektashjan, asgjëmangut, krijoi të gjithë një botë filozofike dhe fetare, në të cilën koncepti i gjithësisë dhe ai i Perëndisë mundin të këmbehen në poezi të kulluar, duke i siguruar autorit të tyre një vend krejt të posaçëm në leteratyrën europjane." (Fragment nga kumtesa e Namik RESULIT mbajtur në Sesionin Shkencor të Shoqërisë *Vatra*, Detroit, 1969.)

Pas fillimeve idealiste të Rilindjes Kombëtare, zë fill e shfaqet aty nga vitet 80-të të shekullit XIX, realizmi politik në vepra si *Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*, 1886, shkruar greqisht nga Naimi, që dëshmom tejkalimin e fazës parakombëtare të Rilindjes sonë. Në këtë fazë ndikimi i huaj vjen e shtohet gjithashtu:

Rrjedhimisht edhe formimi i *Shoqërisë Biblike*, më 1804, në Londër, shihet si kundërveprim idesh ndaj përhapjes së ideve revolucionare të Francës republikane. Në këtë përballje të këtyre dy koncepteve kundërthënëse, nuk kishte se si të mos përfshiheshin edhe popujt e tjerë evropianë, përfshirë këtu edhe shqiptarët. (KRASNIQI, 2013:49)

Fara e mbjellë filloi të rrisë frutat

Me të drejtë ndihet ndikimi i *Qarkut ortodoks të Shqipërisë jugore* (ÇABEJ, 1994: 55), ndonëse autori i cituar E. Çabej, sqaron pak më lart se "Këto qarqe veprojnë krejt pavarësisht njëri nga tjetri, dhe sado pothuaj të një kohe, veprojnë çuditërisht pa njohur fare shoqi-shoqin". Të këtij qarku janë savantët e Akademisë së Voskopojës, të cilët kanë ndikimin e tyre jo vetëm në kulturën e gjuhën shqipe, por edhe mbi kishën ortodokse në Shqipëri. Studiuesit flasin për një patriotizëm të dukshëm shumë para ngjizjes së tij me ideologjinë e Rilindjes, i cili solli një riformatim të raporteve të gjuhës shqipe me gjuhët që përdoreshin në institucionet fetare:

Në pleqësi të Mitropolisë
Korçë më 27ë Prill 1914
Ikonomi Josif.
Së ndershmes Pleqësisë Kishëtare
Zotërinj!

Ne të nënëshkruarit ndenjës të krishterë Orthjodhoksë të këti qyteti vimë me anën e kësaj t'u lutemi që të kini mirësinë të përkujdesi që priftërinjtë tanë të përkujdesen të mësojnë shqip kështu që mesha dhe të tjerat të kënduara të kishës të thuen në gjuhën amtare tënë, që kështu populli të muntnjë të kupëtonjë të shenjtat këndime të fesë tënë orthodhokse. N'është se këta nukë mundin të mësojnë a nukë duan që të mësojnë dhe në ka prej ta që dinë dhe s'duan që të këndojnë u lutemi të mirrni masat e duhura për ta, se ne jemi të zotërit të sjellëmë të tjerë që të jenë njohjtës të gjuhës dhe të vërtetë priftër të fesë tënë orthodhokse.

Veç kësaj u lutemi prapë që priftëria të kujtojnë në meshët emërin e Sh. Së Tij Mbretit tënë Wilhelmit të Irë si kundër kujtonin në kohët të Greqisë Mbretn' e saj.
Duke patur të madhe shpresë se lutja tënë do të merret ndër sy dhe se do të mbaroni dëshirën tënë mbetemi
me shumë nder
Korçë 24/IV/14………………
…………………….. [etj.] (MITKO, 2020: 71)

Më pas, veçmas pas krijimit të *Komisisë Letrare të Shkodrës* (1916-1918), ku ishte anëtar themelues, me veprimtarinë e tij patriotike, arsimore dhe kulturore, H. Aliu vendosi komunikim me *Qarkun katolik të Shqipërisë veriore*. çka ndihet te gjuha e shkruar prej tij në atë periudhë kohore, ku gjenden trajta fonetike ose leksik nga dialekti gegë:

"Se Resulullahu për *na* gjithnjë qante
Shumë kohë s'flinte për *na* s'pinte e s'hante." (KORÇA, 1944: 98)

"M'ardhi Asijeja dhe Merjem e *qrume*
Me një Huri bashkë qiparet e *shkrume*." (KORÇA, 1944: 99)

"Vllezër nga zjarri doni të shpëtoni
Me zemër të *djekme* "essalatu" thoni!" (KORÇA, 1944: 102)

Gjuha e shkrimit te *Mevludi* apo ripunimi i tij para çdo botimi nga H. Aliu është nën ndikimin e *Qarkut ortodoks të Shqipërisë jugore*, apo si e kishte quajtur te *Parthënmja* shqip e *Bleta Shqiptare* Thimi Mitkoja në vitin 1875:
"Këta pra janë ata pak shembuj të gjuhës, që unë vetë i zgjodha, [tregues] të farefisnisë së gjuhës shqipe sidomos me greqishten. Libri im përmban
…………………..
Ç) *Këngë popullore, heroike, erotike, dhe të dasmës, të ndara në dangëllishte-toskërishte, labërishte-çamërishte dhe gegërishte.*" (MITKO, 2020: 439)

Mitkoja i shkrin fare lehtë diferencat gjuhësore mes të folmeve jugore dhe gegërishtes veriore, pra të arealit shqiptaro-ballkanik, e shkruante siç e dëgjonte në Egjipt prej emigrantëve, që i sillnin materiale folklorike për *Bletën* e vet. Më pak ndikim pati në gjuhën e shkruar shqipe treva shqipfolëse arbëreshe:
"Pajtohemi plotësisht me përfundimin e Shaban Demirajt sipas të cilit arbëreshët nuk arritën të kishin një alfabet të përbashkët për shkak të heterogjenitetit kulturor dhe gjuhësor që karakterizonte komunitetet e tyre." (DEMIRAJ, 2017: 6; Matteo Mandala, *Dy fjalë hyrëse*)

Po te kjo fjalë modeste për një botim aq shumë skrupuloz, Matteo Mandala nuk harron të theksojë ndihmesën dhe përpjekjet e intelektualëve të Rilindjes Kombëtare për të zbehur distancën mes toskërishtes dhe gegërishtes, "…, çka i hapi rrugën procesit të formimit të një gjuhe letrare kombëtare."
Është vendi këtu të theksojmë se për të qartësuar rrugën e rritjes së kësaj vepre të H. Aliut nga botimi i parë tek i fundit, kemi pasur të njëjtën prirje ndaj praktikës **ekdotike**, si praktika e konsoliduar me botimet kritike të veprave themelore të letërsisë shqipe prej Shaban Demirajt.
Te botimi i vitit 1944 shkruhet:

Si ajy ta duam iman' e vatanë
Për udhërëfenjës mjaft kemi Kuranë.
Po mbajtmë Kuranë mbajtmë lumtërinë
Me të munt ta mbajmë din' e kombësinë.
Dilni, le t'ju vijë e lehtë ose e rendë[25] - thotë
Zoti, se pa vatan nuk rohet në botë.
…
Zot! Le të na rojë Atdheu' Kombësija
Aqë sa të rrojë edhe gjithësija. (KORÇA, 1944: 117)
…
Bie në sy përgatitja dhe një shije e mirë gjuhësore edhe në të krijuarit e fjalëvet të reja, si: lumtëri, kombësi, atdhe e ndonjë tjetër. Me fjalën e përbërë *at+dhe* = *atdhe*, zëvendësoi neologjizmin e krijuar nga Jani Vreto *mëmëdhe*, përdori neologjizmin *udhërëfenjës*, kurse *lumtëri* (lumturi), *kombësi*, *gjithësi* etj. janë fjalë derivate me prapashtesa, duke shtënë në përdorim prapashtesën produktive *-ri*.

Si rezultat edhe te ribotimi i vitit 1950, kryer në SHBA, ky fragment është i njëjtë. Ndërsa te ribotimi i vitit 1920 fragmenti është i njëjtë, por katër vargje para përfundimit të krijimit nuk gjenden:

…

"Zot! Le të na rojë Atdheu' Kombësija
Aqë sa të rrojë edhe gjithësija.

Kemi të drejtë të gjykojmë se këto dy vargje nuk do të jenë edhe të botimi i Shkodrës, kryer para vitit 1924 dhe sigurisht edhe te botimi i parë, ai i vitit 1900.

Te botimi i vitit 1920, pas vargjeve:

"Po e mira është sa të jemi gjallë
Të dëgjojmë Zonë ta largojmë djallë"

---

[25] "Dilni (*në luftë*), le t'ju vijë (*lufta*) e lehtë ose e rendë, luftoni për hir të All-llahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni."[25] (*Kur'ani*; 9:41; Përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti, Prishtinë 1987),

shtohen vargjet:

"Të kapim vetijat që kish Muhammedi
Se ndryshe s'fitohet vëllezër xhenneti"

Dhe pas tyre fragmenti i mësipërm.

"Si ajy ta duam iman' e vatanë
Për udhërëfenjës mjaft kemi *Kuranë*.
Po mbajtmë *Kuranë* mbajtmë lumtërinë
Me të munt ta mbajmë din' e kombësinë.
Dilni, le t'ju vijë e lehtë ose e rendë[26] - thotë
Zoti, se pa vatan nuk rohet në botë."
…
"Zot! le të na rojë Atdheu' Kombësija
Aqë sa të rrojë edhe gjithësija." (KORÇA, 1944: 117).

Mevludi i vitit 1909, pas vargut: "Të dëgjojmë Zonë ta largojmë djallë", vijon:
"Për sendër (R.O., *sedë*r) të madhe Zot të Pejgamberit"

… dhe mbyllet me vargjet:

"Me zemër të djegur Allah të thëresim
Me Allah në gojë Zot! dhe kur të vdesim!"

Kulti i atdheut (*vatan*) të munguar duke evoluar nga viti 1900 në 1944, e shtyn H. Aliun t'i ftojë bashkatdhetarët të dalin në luftë për hir të Allahut, sepse besimi (imani) duhet dashur si atdheu (vatani).

---

[26] "Dilni (*në luftë*), le t'ju vijë (*lufta*) e lehtë ose e rëndë, luftoni për hir të All-llahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni."[26] (*Kur'ani*; 9:41; Përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti, Prishtinë, 1987)

Ashtu të lidhur pazgjithshmërisht i shihte H. Aliu konceptet patriotike edhe kur përkrahte organizimin nga klubi *Dituria* i mitingut në mbrojtje të abecesë shqipe:

"Më 27 shkurt 1910 u organizua nga klubi *Dituria*, me përkrahjen edhe të atdhetarëve të tjerë si Hafiz Ali Korça etj. Një miting i madh në Korçë në mbrojtje të abecesë shqipe, ku morën pjesë 15.000 vetë nga qyteti dhe rrethi i Korçës, nga Kolonja, Starova, Devolli, Opari dhe nga fshatrat rreth Korçës. … Në dokumentet e kohës mitingu i Korçës cilësohet si një ngjarje historike kombëtare, si një manifestim, i cili shprehu vullnetin e gjithë kombit shqiptar." (DEMIRAJ & PRIFTI, 2008: 140)

Teksti i vitit 1944 nuk qëndron vetëm te kumti fetar, por plotësohet edhe me atë atdhetar. Nga botimi i parë te pasuesit shihet ecuria e formimit kombëtar, gjithnjë e lidhur me atë fetar, pra nga sedër vetjake kalohet te sedra kombëtare duke u prirur drejt ndërgjegjës kombëtare. *Mevludi* ftonte për të marrë përgjegjësitë e kohës historike dhe njëkohësisht nxiste vetiniciativën e individit, veçmas atij që praktikonte islamin:

"Ndryshimi më thelbësor që u bë në vendet protestante, është mënyra e të menduarit dhe e të vepruarit. Tani, mospuna nuk konsiderohej si diçka e shenjtë. Përkundrazi, tash, puna ishte një domosdoshmëri për ta bërë njeriun të lirë dhe të barabartë. Si rezultat i kësaj filozofie të re, që përmbante të gjitha elementet kulturore të sistemit të ri kapitalist si; individualitetin, liberalizmin, përgjegjësinë, disiplinën, vetiniciativën, do të nxiste lulëzimin e industrisë dhe të tregtisë. Në këtë mënyrë vendet nordike u bënë qendra emancipimi dhe shembuj të suksesit për vendet e tjera të krishterimit, atyre katolike ashtu dhe atyre ortodokse të Evropës. Ndërkaq, me përkthimin e *Biblës* në gjuhët popullore, do të nxitet dëshira e njeriut të thjeshtë për t'u arsimuar në mënyrë që vetë ai të jetë në gjendje t'i lexojë shkrimet e shenjta. Ky ishte ai momenti i kthesës drejt një edukimi të organizuar edhe në shkallë kombëtare, fillimisht dukuri kjo vetëm për vendet protestante." (KRASNIQI, 2013:45)

Përfundim

Një lloj protestanizmi u bë kësisoj bektashizmi shqiptar në kuadër të besimeve fetare, që praktikoheshin në vend, duke ndikuar fuqishëm edhe mbi sunizmin, i cili nuk ishte më zyrtar pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar në vitin 1912, që vuri themele laike në historinë e vet shtetformuese dhe pas krijimit të KMSH në vitin 1923.

"Si rrjedhojë e kësaj gjendjeje (R.O, në Evropën Perëndimore) do të vijë deri te një botëkuptim i ri qytetërues: nevoja për emancipim kombëtar e religjioz në gjuhët popullore, që nënkuptonte lirimin e një energjie të madhe krijuese. Rrjedhimisht parimet protestante u bënë parime të botës së qytetëruar, pas të cilave do të shkojnë të gjitha shoqëritë, në fillim ato që i takonin kulturës së krishtere-katolike, për të vazhduar më pastaj nga bota e kulturës së krishterë-ortodokse." (KRASNIQI, 2013: 46)

Myftiu i Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra më 14 dhjetor 1920 u dërgoi një qarkore të gjitha zyrave të sherive në Shqipëri:

"Prandaj, jemi të urdhëruem mos me përdorë gjuhën turqishte ndër akte zyrtare, sikurse e kemi përdorë gjer më sot. Nga ky shkak, sekretarët, ashtu dhe shkruesat e gjyqeve sheri, janë të detyruem me ditë gjuhën kombëtare mirë, si me shkrim ashtu edhe me këndim. Veç kësaj, ilameve (shpalljeve) sheri, përherë do t'u ngjitet një shkurtim në gjuhën shqipe." (AQSH: 882/1921/ 9/ 1.)

Puna e përkushtuar në shërbim të besimit islam, nuk i binte ndesh arritjeve të dukshme të shoqërisë shqiptare, që po evoluonte shpejt dhe me siguri, veçmas pas viteve 20-të të shekullit të kaluar. Mevludi mbështeti kulturën perëndimore, traditë që është konstatuar nga Giuseppe Gradilone, se Naimi "qe një lexues i kujdeshsëm dhe entuziast i poezisë virgjiliane,". (ISMAJLI, 2020: 65). *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë. Përkundrazi, shtonte sinergjinë e krijuar nga komunikimi ndërkulturor midis komuniteteve fetare në vend, i cili përkrahej edhe nga personalitetet e kohës.

Një nga nxënësit e tij të degës normale në Licé, Rrok Zojzi, tregon për drejtorin e gjimnazit shtetëror të Shkodrës dhe më pas ministër i Arsimit, Mirash Ivanaj:

"Mbasi na ndau diplomat dhe na përshëndeti në ceremoninë e rastit, drejtori tha: *Kjoftë livdue Jezu Krishti*. Dikush muer guximin dhe reagoi e ai me atë taktin e tij foli si me shokun e vet: *Po unë nuk jam shfaqë kurrë kundër fesë*. Mandej tha se kishte nji lutje për ne, se kishte mbetë pa zhvillue kapitulli i optikës në fizikë dhe na kërkoi nji javë për ta zhvillue. E kush ia prishte të madhit Ivanaj?"

Për ministrin e suksesshëm që kreu reformën arsimore në kohën e Mbretërisë Shqiptare, rrëfejnë edhe të tjerë që kanë bashkëpunuar me të nga afër:

